



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK

RELACION

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE PËR
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 NË NIVEL PROGRAMI**

Në zbatim të udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, udhëzimit nr. 7 datë 25.2.2022 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, udhëzimit plotësues nr. 21 datë 7.7.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB nr. 1 datë 16.1.2023 “Për miratimin e kalendarit të PBA 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024, Bashkia Korçë”, VKB nr. 13 datë 25.1.2023 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave”, si dhe VKB nr. 64 datë 27.4.2023 “Për miratimin e taveve përgatitore të programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026 në nivel programi, Bashkia Korçë ka përgatitur tavanet përfundimtare të PBA 2024-2026 në nivel programi sipas formatit D1 të Instrumentit të Planifikimit Financiar.

Udhëzimi plotësues për përgatitjen e Programit 2024-2026 përmban:

- ✓ Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA vendor 2024-2026;
- ✓ Afatet për përgatitjen e buxhetit
- ✓ Mbështetja këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes vendore

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA vendor 2024-2026;

Një hap i rëndësishëm për të garantuar që procesi i planifikimit të shpenzimeve të programit të jetë në përputhje me parashikimin e të ardhurave, stabilitetin fiskal si dhe prioritetet strategjike të NJVQV-së, është vendosja e taveve të shpenzimeve. Një “tavan” në këtë kontekst është kufiri i sipërm i shumës totale të parave që mund të shpenzohen ose të planifikohen për t’u shpenzuar për një qëllim të caktuar. Me alokimin e taveve të përgatitjes së PBA vendor 2024-2026 për programet buxhetore, Këshilli i NJVQV-së garanton që shpenzimet të planifikohen në

mënyrë që të buxhetojnë politikat, prioritetet, objektivat strategjike të NJVQV -së dhe të jenë në përputhje me alokimin strategjik të burimeve.

- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për PBA vendor 2024-2026 të miratuara nga KB, do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2024.
- Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është mbështetur në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, në ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe në VKB nr. 13 datë 25.1.2023 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave”. Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Korçë mbështetet në politikat fiskale të përcaktuara në Paketën Fiskale të Bashkisë Korçë, të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 168, datë 24.11.2022 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Korçës, si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2023", e cila përcakton llojet e taksave dhe tarifave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga ana e Bashkisë, për vendosjen e taksave dhe tarifave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Në mënyrë të hollësishme përveç strukturimit, detajon çdo lloj takse dhe tarife, përcakton qartë administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e përlllogaritjes, personat përgjegjës të pagimit dhe të mbledhjes të taksës apo tarifës. Gjithashtu parashikimi bazohet në kapacitetin ekzistues të taksave e tarifave vendore, sipas informacionit të përfituar nga programi i taksave vendore, informacionit të zyrës së gjëndjes civile, informacionit të trashëguar në njësitë administrative nga ish-komunat, informacionet e shkëmbyera me A.SH.K, D.R.SH.T.RR, D.R.T - Korçë, dhe institucione të tjera. Ky parashikim merr gjithashtu parasysh impaktin që do të ketë në të ardhurat e viteve të ardhshme të Bashkisë Korçë.

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Transferta për periudhën 2024-2026 do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2024-2026, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2024-2026 dhe konkretisht transferata e pakushtëzuar e përgjithshme jepet si më poshtë:

2023 në vlerën 532,062 mijë lekë

2024 në vlerën 560,733 mijë lekë, me një rritje prej 28,671 mijë lekë krahasuar me vitin 2023 ose 5.4%

2025 në vlerën 590,771 mijë lekë me një rritje prej 30,038 mijë lekë krahasuar me vitin 2024 ose 5.4%

2026 në vlerën 621,708 mijë lekë me një rritje prej 30,937 mijë lekë krahasuar me vitin 2025 ose 5.2%

Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2024-2026 janë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2024-2026, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime, do të bëhen në përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga te ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2024-2026, do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar në buxhetin e vitit 2023. Transferta e pakushtëzuar sektoriale do të jetë 1 përqind më e lartë për çdo vit buxhetor (në vitin 2024 do të jetë 1% më e lartë se sa në 2023, në 2025 do të jetë 1% më e lartë se sa në 2024 dhe në vitin 2026 do të jetë 1% më e lartë se sa në vitin 2025) dhe konkretisht sipas tabelës C3 të Instrumentit të Planifikimit financiar.

Tabela C3, 000/lekë

(C3) TË ARDHURA ME DESTINACION

			2023	2024	2025	2026
			Trashëgimi me destinacion	Transferata e Pakushtezuar Sektoriale		
Programi	AA122	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	0	0	0	0
Programi	AB122	Siguria Publike	32,730	33,057	33,387	33,721
		Mbrojtja nga zjarri	32,730.00	33,056.82	33,387.39	33,721.26
Programi	AC122	Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor	16,375	16,538	16,704	16,871
		Administrimi i pyjeve	16,375.00	16,538.27	16,703.66	16,870.69
Programi	AD122	Mbrojtja e Mjedisit	0	0	0	0
Programi	AE122	Shërbimet Publike Vendore	56,365	56,928	57,498	58,073
		Rrugët	7,265.00	7,337.18	7,410.55	7,484.66
		Ujitja dhe Kullimi	49,100.00	49,591.31	50,087.22	50,588.09
Programi	AF122	Kultura, Sport dhe Argëtim	0	0	0	0
Programi	AG122	Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor	199,821	201,820	203,838	205,876
		Arsimi Parashkollor: Për personelin mësimor	199,821.00	155,259.21	156,811.81	158,379.92
		Arsimi Parashkollor: Për stafin mbështetës		46,560.32	47,025.92	47,496.18
Programi	AH122	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	43,191	43,623	44,059	44,500
		Arsimi parauniversitar	20,413.00	20,617.54	20,823.72	21,031.95
		Konviktet e arsimit parauniversitar	22,778.00	23,005.68	23,235.74	23,468.10
Programi	AI122	Përkujdesi Social	0	0	0	0
Programi	AJ122	Fondi Rezervë	0	0	0	0
Programi	AK122	Fondi Kontigjencë	0	0	0	0
Totali			348,482	351,966	355,486	359,041

Këto tavane për Bashkinë Korçë janë ndërtuar për 11 programe të cilat përfshijnë 27 funksione dhe konkretisht si më poshtë:

Programi AA122 Planifikimi, Menaxhim dhe Administrim

Programi AB122 Siguria Publike

Programi AC122 Mbështetje për Zhvillim Ekonomik Vendor

Programi AD122 Mbrojtja e Mjedisit

Programi AE122 Shërbime Publike Vendore

Programi AF122 Kultura, Sport dhe Argëtim

Programi AG122 Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Parashkollor

Programi AH122 Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm

Programi AI122 Përkujdesi Social

Programi AJ122 Fondi Rezervë

Programi AK122 Fondi i Kontigjencës

Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës janë planifikuar si më poshtë:

2024 20,000 mijë lekë

2025 20,000 mijë lekë

2026 20,000 mijë lekë

Burimet e financimit të detajuara për vitet 2024-2026 paraqiten si më poshtë:

/lekë

	Të ardhurat	2024	2025	2026
1	Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore	1,204,663	1,216,710	1,228,877
2	Transferta e pakushtëzuar	560,733	590,771	621,708
3	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	351,967	355,486	359,041
	Total	2,117,363	2,162,967	2,209,626

Në zbatim të udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, udhëzimit nr. 7 datë 25.2.2022 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, udhëzimit plotësues nr. 21 datë 7.7.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB nr. 1 datë 16.1.2023 “Për miratimin e kalendarit të PBA 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024, Bashkia Korçë”, VKB nr. 13 datë 25.1.2023 “Për

vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave”, si dhe VKB nr. 64 datë 27.4.2023 “Për miratimin e taveve përgatitore të programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026 në nivel programi, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e taveve përfundimtare të PBA 2024-2026 në nivel programi sipas formatit D1 të Instrumentit të Planifikimit Financiar, Bashkangjitur relacionit tabela e taveve përgatitore të PBA 2024-2026 në nivel programi sipas formatit D1 të Instrumentit të Planifikimit Financiar 2024-2026.

DREJTORE E DREJTORISË
SË PËRGJITHSME SË FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK
VALBONA ZIKO

DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSME
JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE
ANXHELA QERAMIXHI (DISHNICA)

DREJTOR I DREJTORISË
SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE
SONIEL PRIFTI

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM
Nr. Datë

**PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE PËR
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2024-2026 NË NIVEL PROGRAMI**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026 në nivel programi”, në zbatim të udhëzimit nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2024-2026”, udhëzimit nr. 7 datë 25.2.2022 “Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore”, udhëzimit plotësues nr. 21 datë 7.7.2023 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026” ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, VKB nr. 1 datë 16.1.2023 “Për miratimin e kalendarit të PBA 2024-2026 dhe të buxhetit vjetor 2024, Bashkia Korçë”, VKB nr. 13 datë 25.1.2023 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave”, si dhe VKB nr. 64 datë 27.4.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të programit buxhetor Afatmesëm 2024-2026 në nivel programi, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 në nivel programi, për Bashkinë Korçë sipas formatit D1 të Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Korçë dhe Institucionet e Varësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

K R Y E T A R

Ana VERUSHI

Miratuar me _____vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____